

EKSTRAKT I KUSHTEVE TË KONTRATES SË SIGURIMIT

JETË E KOMBINUAR

Në zbatim të Ligjit Nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” Shoqëria e Sigurimit SiCRED sh.a. dhe Statutit e shoqërisë SiCRED sh.a. paraqesim si vijon ekstrakt të kushteve të Kontratës së Sigurimit.

Kontrata e Sigurimit Jeta e Kombinuar është kontrata me anë të së cilës, Siguruesi dhe i Siguruari bien dakord që kundrejt pagimit të primit të sigurimit në favor të Siguruesit, në përputhje me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta (nëse ka) të kësaj kontrate, siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguararin në mënyrën dhe masën e parashikuar në këtë kontratë, nëse ndodh të vërtetohet rasti i sigurimit.

1.1 Përcaktime

- a) Kushtet e përgjithshme të kontratës së sigurimit të Kombinuar të Jetës, polica e sigurimit dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet atyre, do të quhet “**Kontrata e Sigurimit**”.
- b) Kushtet e përgjithshme (dhe të veçanta, nëse ka) të kontratës së sigurimit të Kombinuar të Jetës, do të quhen “**Kushtet e Sigurimit**”.
- c) Shoqëria e sigurimit SiCRED sh.a.do të quhet “**Siguruesi**”.
- d) Personi fizik, pjesëmarrës në Grupin e Siguarar, jeta e të cilit do të sigurohet sipas kontratës së sigurimit të Kombinuar të Jetës, do të quhet “**I Siguruari**”.
- e) Personi fizik apo juridik që nënshkruan kontratën e sigurimit, do të quhet “**Kontraktuesi**”.
- f) Dokumenti që provon lidhjen e kontratës së sigurimit, këtu e më poshtë do të quhet “**Polica e Sigurimit**”.
- g) Dëshmia e sigurimit që Siguruesi i lëshon të Siguararit, do të quhet “**Çertifikata e Sigurimit**”.
- h) Personi fizik apo juridik që përfiton nga kontrata e sigurimit mbi bazën e vullnetit të shprehur nga i Siguruari në Çertifikatën e Sigurimit, do të quhet “**Përfituesi**”.
- i) Shuma e mjeteve monetare që i Siguruari dhe/ose Kontraktuesi i paguajnë Siguruesit për lidhjen e kësaj kontrate, këtu e më poshtë, do të quhet “**Prim i Sigurimit**”.
- j) Shuma maksimale e mjeteve monetare që Siguruesi merr përsipër të paguajë me vërtetimin e rastit të sigurimit, në favor të të Siguararit apo Përfituesit, do të quhet “**Shuma e Sigurimit**”.
- k) Shuma e mjeteve monetare që Siguruesi i paguan të Siguararit apo Përfituesit, me vërtetimin e ngjarjes së sigurimit, do të quhet “**Përfitim**”.
- l) Në rastet kur pagesa e primit të sigurimit, sipas kushtet e kësaj kontrate sigurimi, do të bëhet nga i Siguruari , tërësisht ose pjesërisht, kjo kontratë do të quhet “**Kontratë Sigurimi Kontributor në Grup**”.
- m) Në rastet kur pagesa e primit te sigurimit, sipas kushteve të kësaj kontrate sigurimi, do të bëhet nga punëdhënësi, kjo kontratë do të quhet “**Kontratë Sigurimi në Grup**”.
- n) Punëdhënësi, i cili paguan plotësisht apo pjesërisht primin në favor të të Siguararit, do të quhet “**Policëmbajtësi**”.
- o) Humbja e jetës së të Siguararit, si dhe të gjitha llojet e paaftësisë së personit, sëmundjet kritike të përmendura në këtë kontratë kur ato nuk përfshihen në rreziqet e përjashtuara të kësaj kontrate sigurimi, do të quhen “**Rasti i Sigurimit**”.
- p) Humbja e jetës ose paaftësia e të Siguararit që shkaktohet nga mjete të rastit, të dhunshme, të dukshme, të jashtme, të pavarura nga vullneti i të Siguararit, do të quhet “**Aksident**”.

- q) Vdekja e të Siguruarit, pavarësisht nëse është shkaktuar ose jo nga Aksidenti, me përjashtim të rreziqeve të përjashtuara në këtë kontratë sigurimi, do të quhet **“Vdekja e të Siguruarit”**.
- r) Humbja e plotë e funksionit të muskullit apo ndjeshmërisë në të dy gjymtyrët e poshtme apo të sipërme, si rezultat i sëmundjeve dhe që shkakton paaftësi e cila zgjat për një periudhë të vazhdueshme prej 12 muajsh kalendarik, përcaktuar nga neurologu, do të quhet **“Paraliza”**.
- s) Humbja e plotë e aftësisë së të Siguruarit për të kryer detyrat në profesionin e tij, ose në çdo profesion tjetër, shkaktuar nga aksidenti, e vërtetuar si e tillë nga autoriteti mjekësor kompetent, pas mbarimit të periudhës prej një viti nga fillimi i paaftësisë, do të quhet **“Paaftësi e Përhershme e Plotë”**.
- t) Humbja e pjesshme e aftësisë për punë, shkaktuar nga aksidenti, me pasojë humbjen anatomike apo dëmtimin funksional të përhershëm të një ose disa organeve apo gjymtyrëve të të Siguruarit, do të quhet **“Paaftësi e Përhershme e Pjesshme”**.
- u) Humbja e plotë e aftësisë së të Siguruarit, shkaktuar nga aksidenti, për të përmbushur përkohësisht detyrat në profesionin e tij, do të quhet **“Paaftësi e Përkohshme e Plotë”**.
- v) Humbja e pjesshme e aftësisë së të Siguruarit, shkaktuar nga aksidenti, për të përmbushur përkohësisht detyrat në profesionin e tij, do të quhet **“Paaftësi e Përkohshme e Pjesshme”**.
- w) Shpenzimet e kryera për trajtim spitalor dhe ndërhyrjet kirurgjikale, shpenzimet për blerjen e medikamenteve mjekësore të rekomanduara nga mjeku, trajtimin me rreze, shpenzimet e bëra për transportin e të Siguruarit për në spital (kur ky transportim kërkon kushte specifike), të cilat lindin si pasojë e aksidentit, apo sëmundje kritike të përcaktuar në objektin e kësaj kontrate, do të quhen **“Shpenzime Mjekësore”**.
- x) Humbja fizike ose funksionale e një dore, në ose mbi artikulationin e bërrylit, apo e një këmbe, në ose mbi artikulationin e gjurit, do të quhet **“Humbje Gjymtyre”**.
- y) Limiti maksimal i shumës monetare që Siguruesi merr përsipër të paguajë në ndodhjen e rastit të sigurimit, do të quhet **“Përgjegjësi Agregate”**.
- z) Kohëzgjatja për të cilën është në fuqi kontrata e sigurimit, këtu e më poshtë do të quhet **“Periudha e Sigurimit”**.

1.2 E Drejta për të ei Siguruar

- a) Kanë të drejtë të sigurohen persona me moshë nga 18 vjeç deri në 65 vjeç, anëtarë të “Grupit të Sigurimit” që janë të punësuar definitivë dhe që punojnë me kohë të plotë dhe që janë të aftë të përmbushin detyrat e tyre profesionale.
- b) Nuk do të konsiderohen të siguruar ata persona që kërkojnë kujdes të përhershëm mjekësor ose që e mbështesin jetën në kujdesin e të tretëve.
- c) Të Siguruarit që arrijnë moshën kufi 65 vjeç, kur polica e sigurimit është në fuqi, do të mbeten të mbuluar deri në mbarim të afatit të treguar në policën e sigurimit.

1.3 Përfitimet e Pagueshme

1. Sipas kushteve të kësaj kontrate, Siguruesi ofron mbulim për:

- a) Vdekja e personit të siguruar pavarësisht për shkaqe natyrore apo aksidentale;
- b) Shfaqja apo diagnostikimi i njëjës prej Sëmundjeve Kritike:
 - 1. Ataku i zemrës
 - 2. Goditja cerebrale
 - 3. Kanceri
 - 4. Pamjaftueshmëria e të dy veshkave
 - 5. Kirurgjia e artereve koronare
 - 6. Paraliza

- c) Dëmtimi aksidental i të Siguararit, me pasojë:
- I. Paaftësinë e përhershme
 - II. Paaftësinë e përkohshme

1.4 Përjashtime

Për efekt të kësaj kontrate sigurimi, nuk do të mbulohet rasti i sigurimit shkaktuar në kushtet:

- d) Lufta (vetëm nëse është e shpallur nga organet kompetente), veprimet ushtarake, lufta civile, rebelimi, kryengritja e armatosur dhe akte terroriste.
- e) Veprimi i armëve të shkatërrimit në masë si armët bërthamore dhe bakteriologjike.
- f) Kontaminimi radioaktiv, shpërthimet bërthamore, përmbytjet, zhvendosja e tokës, tërmetet, shpërthimet vullkanike.
- g) Drejtimi i mjeteve motorrike tokësore, ujore, ajrore, pa qenë i pajisur me dëshminë përkatëse të aftësisë, pjesëmarrja në ngjitje alpinistike, fluturimi me avion i çdo lloji (përveç kur udhëton vetëm si pasagjer), ushtrimi i sporteve dimërore, garat me kuaj, makina dhe motoçikleta etj.
- h) Përdorimi i lëndëve eksplozive dhe korrozive, përveç kur është në përmbushje të detyrës profesionale.
- i) Përfshirja e të Siguararit në akte kriminale dhe veprimtari të paligjshme.
- j) Vetëvrasja, nëse ndodh brenda 6 muajve të parë të lidhjes së kontratës.
- k) Aktet e kryera me dashje apo të tentuara nga Policëmbajtësi, Kontraktuesi apo Përfituesi në dëm të të Siguararit.
- l) Pjesëmarrja e të Siguararit në sulme apo veprime e kundërveprime të dhunshme të provokuara nga të tretët, përveç kur i Siguarari vepron në kushtet e vetëmbrojtjes a të nevojës ekstreme.
- m) Influenca e alkolit, drogës, sëmundjet veneriane, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, sëmundjet si pasojë e virusit HIV.
- n) Çdo lloj defekti fizik apo mendor pre-ekzistues, përveçse kur është deklaruar me shkrim nga i Siguarari dhe është pranuar nga Siguruesi.
- o) Ndërhyrjet kirurgjikale, kontrollet apo kurimi për pasoja që nuk lidhen me kushtet e mbulimit në sigurim sipas kësaj kontrate.
- p) Përjashtohen nga përfitimi për paaftësi të çdo lloji, e përhershme apo e përkohshme, që shkaktohet nga sëmundje apo patologji të ekzistuar më parë, apo të shfaqura pas hyrjes në fuqi të kontratës, gjatë shtatzënisë, lindjes së fëmijës apo abortit, pavarësisht nga natyra e tyre që do të përbënin rrethanë apo fakt, me njohjen e të cilave Siguruesi nuk do të pranonte lidhjen e kontratës së sigurimit.
- q) Përfitimi për sëmundjet kritike, nëse ato janë të njohura, trajtuara apo diagnostikuara gjatë një viti para marrjes në sigurim.
- r) Sëmundjet që shfaqen në tremujorin e parë të policës.
- s) Për efekt të kësaj kontrate përjashtohen:
 - Të gjithë kancerat e lëkurës, përveç Melanomës Malinje,
 - Të gjithë kancerat që trajtohen me anë të heqjes kirurgjikale dhe që nuk kërkojnë ndërhyrje apo trajtime mjekësore të mëtejshme (si kimioterapi, radioterapi, terapi me rreze lazer),
 - Leucemia kronike limfocite,
 - Kanceri i prostatës, faza A
 - Sarkoma Kaposi, si dhe të gjithë kanceret e shoqëruar me HIV,
 - Aksidentet cerebrovaskulare që lënë pasoja vetëm në sy,

- Defektet neurologjike për shkak të migrenës,
- Angioplastika me ballon dhe lazer e artereve koronare.

1.5 Paraqitja e Dokumentacionit për Trajtim Rast Dëmi

- a) Me ndodhjen e rastit të sigurimit, i Siguruari apo Përfituesi detyrohen të njoftojnë Siguruesin duke specifikuar rrethanat e ngjarjes dhe pasojat e saj, si dhe të zbatojnë porositë e dhëna nga Siguruesi.
- b) Një njoftim i tillë do të quhet i dhënë Siguruesit menjëherë nëse është bërë me shkrim brenda 24 orëve nga ndodhja e rastit të sigurimit dhe në çdo rast, jo më vonë se 48 orë nga çasti kur i Siguruari është në gjendje mendore a fizike të kryejë njoftimin, nga çasti kur familjarët e të Siguarit a Përfituesi kanë dijeni për vërtetimin e ngjarjes së sigurimit.
- c) Për të gjitha pagesat e përfitimit që do të bëjë Siguruesi, duhet të dorëzohen paraprakisht këto dokumenta:
 - I. Çertifikata e lindjes së të Siguarit
 - II. Kërkesa për përfitim së bashku me çertifikatën e Sigurimit dhe/ose policën e sigurimit
 - III. Çdo dokument i kërkuar nga Siguruesi i cili vërteton detyrimin e tij për të paguar
- d) Dokumentacioni i plotë i dorëzohet Siguruesit. Shpenzimet për grumbullimin dhe dërgimin e dokumentacionit janë në ngarkim të të Siguarit a Përfituesit.
- e) Siguruesi duhet të paguajë dëmshpërblimin që rrjedh nga kjo kontratë sigurimi brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së dokumenteve të nevojshme dhe që konsiderohen të plota. Çdo pagesë bëhet në monedhën e treguar në kontratën e Sigurimit.

1.6 Taksat dhe Tatimet

- a) Taksat dhe tatimet e detyrueshme sipas ligjit, janë në ngarkim të Policëmbajtësit dhe/ose të Përfituesve.